

Në pajtim me nenin 55 paragrafi 1 i Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare" Gazeta e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 161/2019), Ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi plan-program të shkurtuar për lëndën Shoqëria për klasën V të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/21.

PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR

SHOQËRIA

Gusht 2020

Klasa V

ARSIMI FILLOR

NËNTËVJEÇAR



MINISTRIA PËR ARSIM DHE SHKENCË
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Shoqëri bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën që zbatohet rregullisht në përputhje me programin mësimor të përcaktuar.

Me programin mësimor të shkurtuar përcaktohen tema të caktuara/fusha mësimore dhe njësi mësimore që duhet të realizohen gjatë 159 ditëve mësimore, me kohëzgjatje prej 30 minutash, me çka ruhet fondi i parashikuar javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, 2 orë në javë, respektivisht, 64 orë gjithsej.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, konceptet, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Vështrim i temave dhe njësive mësimore

TEMA 1: ATDHEU YNË – REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT (25 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Atdheu ynë është Republika e Maqedonisë së Veriut
2. Republika e Maqedonisë së Veriut dhe fqinjët e saj
3. Simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
4. Vendndodhja e Republikës së Maqedonisë së Veriut
5. Shkupi është kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut
6. Karakteristikat natyrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
7. Periodizimi i së kaluarës maqedonase
8. Maqedonia në mesjetë
9. Sundimi osman në Maqedoni
10. Maqedonia gjatë Luftërave Ballkanike

11. Maqedonia gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore
12. Formimi i një shteti modern maqedonas
13. Rregullimi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
14. Popullsia e Republikës së Maqedonisë së Veriut
15. Ekonomia dhe aktivitetet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut
16. Turizmi në Republikën e Maqedonisë së Veriut
17. Ndikimi i faktorëve natyrorë në zhvillimin e ekonomisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut
18. Pasuritë minerale, një faktor në zhvillimin e ekonomisë
19. Turizmi në Republikën e Maqedonisë së Veriut
20. Jeta kulturore dhe institucionet kulturore në Republikën e Maqedonisë së Veriut
21. Fetë dhe institucionet fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut
22. Të drejtat dhe detyrat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut

TEMA2: PERSONALITETI (INDIVID) NË GRUP DHE NË SHOQËRI (18 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Jeta personale e individit
2. Personaliteti dhe jeta në grup
3. Ndikimi i njeriut në mjedis
4. Socializimi i personit në grup
5. Faktorët e socializimit
6. Roli i familjes, grupit të bashkëmoshatarëve, shkollës dhe medias
7. Devijimi dhe sjellja devijante e personit në grup
8. Rregullat e sjelljes në mjedis dhe kryerja e detyrave
9. Koncepti i konfliktit

10. Shkaqet e konflikteve
11. Metodot e zgjidhjes së konflikteve
12. Të drejtat themelore të njeriut
13. Të drejtat e fëmijëve si të drejta të njeriut

TEMA 3: REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT NË BOTË (21 ORË)

Njësitë mësimore:

1. Trashëgimia kulturore në tokën e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Thesari multi-kulturor maqedonas
3. Monumentet e kulturës
4. Muzetë në qytetin e Shkupit
5. Emigrimi nga Republika e Maqedonisë së Veriut
6. Të huajt në Republikën e Maqedonisë së Veriut
7. Republika e Maqedonisë së Veriut dhe integrimi evropian - Bashkimi Evropian
8. Institucionet e Bashkimit Evropian
9. Simbolet e Bashkimit Evropian
10. Funksionet kryesore të institucioneve evropiane
11. Problemet kryesore në botë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut
12. Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë së Veriut në zgjidhjen e problemeve në botë
13. Energjia - mundësitë alternative
14. Bota globale dhe trafiku

3. Rekomandimet didaktike

Baza themelore për realizimin e programit mësimor të shkurtuar për lëndën Shoqëria është programi mësimor i rregullt (qëllimet specifike, konceptet, aktivitetet dhe metodat e propozuara). Programi mësimor i shkurtuar për klasën e pestë në lëndën e Shoqërisë përmban tre tema. Për secilën temë jepet numri i përgjithshëm i orëve që duhet të realizohen gjatë vitit shkollor 2020/2021. Ato përputhen me rekomandimet për realizimin e orëve brenda 159 ditëve mësimore. Për realizimin e programit, mësimdhënësi, përveç njësive mësimore për zhvillimin e përmbajtjeve të reja, duhet të planifikojë njësi mësimore të cilat do të përfshijnë vizita, hulumtime, biseda dhe diskutime që do të çojnë në përvetësimin, identifikimin, zgjerimin dhe thellimin e njohurive të nxënësve.

Për zbatimin cilësor dhe efikas të programit është i rëndësishëm planifikimi i mësimdhënësit, i cili duhet të bazohet në qëllimet, udhëzimet didaktike, d.m.th. format, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin mësimor të rregullt. Për më tepër, mësimdhënësi duhet të marrë parasysh karakteristikat e zhvillimit dhe njohuritë e fituara më parë të nxënësve për lëndën specifike. Duke pasur parasysh këtë, ai duhet të bëjë një zgjedhje të përshtatshme të mjeteve dhe materialeve mësimore, të projektojë dhe të ofrojë veprimtari interesante dhe stimuluese për nxënësit dhe që shpesh duhet të dalin nga situatat reale të jetës. Realizimi efektiv i njësive mësimore në këtë plan-program, veçanërisht për formimin e koncepteve nga nxënësit, varet shumë nga zbatimi i qasjes së integruar. Kjo do të thotë që gjatë planifikimit të temë /orëve ditore në Shoqëri, mundësitë për lidhje të integruar me lëndët tjera të përdoren në maksimum: gjuha amtare, matematika, arsimit figurativ, arsimit muzikor dhe arsimit fizik dhe shëndetësor. Në këtë drejtim, mësimdhënësi mund të përdorë gjithashtu punëtoritë e programit të arsimit për aftësitë jetësore, të cilat ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për të trajtuar me sukses sfidat e jetës së përditshme. Duke u nisur nga qëllimet e të mësuarit, kurdoherë që është e mundur, në procesin e të nxënësve duhet t'u mundësohet që të zgjedhin aktivitete dhe përmbajtje të ndryshme në përputhje me interesat e tyre subjektive. Metodatat më efektive në mësimdhënie në Shoqëri janë ato metoda që i vendosin nxënësit në një pozicion aktiv adekuat në procesin e fitimit të njohurive. Është e nevojshme që mësimdhënësi të krijojë situata mësimore në të cilat do të vijnë

në shprehje aktivitete të ndryshme, të cilat mundësojnë mënyra të ndryshme të të mësuarit, përdorimin e mjeteve, materialeve dhe burimeve të ndryshme të të nxënit, në përputhje me mundësitë dhe kohëzgjatjen e mësimit prej 30 minutash.

4. Normativi për kuadrin arsimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në pajtim me normativin për kuadrin arsimor të dhënë në plan-programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën Shoqëria për klasën e pestë të shkollimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e konfirmoi:

Ministri për arsim dhe shkencë

Mila Carovska